



Minutat e takimit në komunën e Drenasit

Datë: 11.05.2018

Pjesmarrës: Lumnije Krapë (drejtoreshë e DSHPE); Afrim Prokshi (DSHPE-Drenas); Drita Gjoka (DSHPE); Flora Krasniqi (DSHPE); Ariana Sadiku (D. INSPEKSIONIT-Drenas); Muhamer Çela (KRM PASTRIMI-Drenas); Shpend Bogiqi (DSHPE-Drenas); Besart Bajrami (DPUUM-Drenas); Arian Toska (ekspert nga GIZ); Pajtim Kastrati (Projekt Koordinator i GAC, Prishtina); Ndriqim Bujupi (KRM PASTRIMI-Drenas).

Qëllimi i takimit

Temat e diskutuara: fillimi i skemës së ndarjes së mbeturinave të riciklueshme, në kuadër të projektit "Zbatimi i skemës së ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim", si dhe monitorimi i PGM, në qendër të qytetit.

Përmbajtja

Fillimisht drejtoresha znj. Krapë falendëroj grupin punues si dhe informoj z. Toska për lancimin e projektit i cili ka filluar me 23.04.2018, ku edhe vendosja e kontejnerëve në PGM është në përfundim e sipër.

z. Kastrati theksoj se nga ana e GAC, në bashkpunim me komunën dhe KRM "Pastrimi", ka zhvilluar informim të bizneseve dhe ekonomive familjare me qëllim vetëdijësimin e tyre për fillimin e ndarjes së mbeturinave të riciklueshme. Gjithashtu edhe me anë të Klubëve të Gjëlbra, janë zhvilluar disa puntori dhe aktivitete si dhe po ashtu janë bërë takimet me qytetarë dhe biznese derë më derë nga këto klube, ku janë shpërndarë fletushka dhe fllajera për informim. Me këto klube se bashku janë vendosur edhe disa postera në çdo hymje të banesave kolektive, për fillimin e ndarjes së mbeturinave, ndërsa tani me anë të komunës do t'i ftojme të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtari në pilot zonë, në një takim të radhës me qëllim fuqizimin e ndikimit të tyre në ndarjen e mbeturinave.

z. Toska theksoj se të gjitha këto janë të mirëpritura në kuadër të projektit, mirpo duhet përdorur metoda të ndryshme dhe të fillojmë nga fëmijet në vetëdijësimin e tyre për ndarjen e mbeturinave. Dhe kjo bëhet duke stimuluar ata me ndonjë shpërblim apo diçka të tillë. Mirpo më e rëndësishmja është kjo që çdo gjë të fillojë nga fëmijet në ato shkolla të cilat janë të përfshiera brenda pilot zonës së projektit.

z. Qela shpalosi sfidat e tyre si kompani "Pastrimi". Ai përmendi që premtimin e dhënë nga MMPH-ja që do t'i sigurojnë 6 punëtorë, nga 1 Maj, ende nuk është realizuar për shkaqe të shumta dhe kjo rezulton në vështirësi të operimit, mirpo fillimisht mund të përballojë, pasi ky proces është në fazat e para testuese. Nga monitorimi i deritanishëm në PGM, në fillim ka filluar mirë të respektohet ndarja nga ana e qytetarëve, por tani ka filluar që në kontjenerët për mbetje të riciklueshme të ketë përzierje.



Është hasur një person i moshuar që po i merr kanaqet dhe plastikën në këta kontejnerë, mirpo jo diqka që mund të dëmtoj procesin e operimit.

Gjithashtu si vërejtje nga grupi punues u dha që stikerat e vendosur në kontejnerë, nuk janë të qarta për qytetarët, gjë që kjo mund të jetë si arsye e hezimit nga ana e tyre që t'i identifikojnë së për çka janë të destinuara ata kontejnerë. Pra stikerat sipas tyre kanë shumë shkrim dhe fotot janë shumë të paqarta në to, ndërsa po t'i shikojmë nga një këndvështrim, të dy stikerat e dy llojeve të kontejnerëve duken të njejta.

Pas vizitës në disa nga pikat grumbulluese, pamë që në disa pika, ndarja e mbeturinave deri diku është e mirë, ndërsa në disa pika tjera jo e mirë. Kjo mbetet që në vazhdim të bëhen takimet me qytetarë në informimin dhe vetëdijësimin e tyre për respektimin e skemës së ndarjes së mbeturinave të riciklueshme.

Përfundimet

- *Vazhdimi i takimeve me qytetarë;*
- *Takimi me biznese;*
- *Angazhimi i fëmijeve në shkolla përmes metodave të ndryshme, duke përdorur edhe Klubet e Gjelbra;*
- *Ndërrimi i stikerave në kontejnerë;*
- *Hartimi i draftit deri në javën e ardhshme.*

Nga:

Pajtim KASTRATI

Projekt Koordinator

Drenas

